



Federata Shqiptare e Futbollit

KODI I ETIKËS

Botim zyrtar, 2019

Federata Shqiptare e Futbollit

President:

Armand DUKA

Sekretar i Përgjithshëm:

Ilir SHULKU

Themeluar: 1930

Anëtare e UEFA-s: 1954

Anëtare e FIFA-s: 1930

Realizoi botimin: “Reklama”

PËRMBAJTJA

HYRJE	9
PËRKUFIZIMET	11
PJESA I. QËLLIMI I ZBATIMIT	13
Neni 1. QËLLIMI I ZBATIMIT	13
Neni 2. SUBJEKTET E KODIT	13
Neni 3. ZBATIMI NË KOHË	14
Neni 4. QËLLIMI I KODIT, MOSVEPRIMET, POROSITË, DOKTRINA DHE JURISPRUDENCA	14
Neni 5. NDARJA E KOMISIONIT TË ETIKËS, NDARJA E PROCEDURAVE	14
PJESA II. FUSHËVEPRIMI I APLIKIMIT MATERIAL	15
Seksioni 1: Bazat për dënime	15
Neni 6. PARASHIKIMI I DËNIMEVE	15
Seksioni 2: Masat disiplinore	15
Neni 7. LLOJI I DËNIMEVE	15
Neni 8. PEZULLIMI I PJESSHËM I DËNIMEVE	15

Seksioni 3: Përcaktimi i dënimit	16
Neni 9. RREGULLA TË PËRGJITHSHME	16
Neni 10. SHKELJA E PËRSËRITUR	16
Neni 11. SHKELJE TË NJËKOHSHME	17
Seksioni 4: Afatet e parashkrimit	17
Neni 12. AFATET E PARASHKRIMIT	17
Seksioni 5: Rregullat e sjelljes	17
<i>Nën-seksioni 1: Detyrat</i>	17
Neni 13. DETYRAT E PËRGJITHSHME	17
Neni 14. DETYRIMI I NEUTRALITETIT	18
Neni 15. DETYRIMI I BESNIKËRISË	18
Neni 16. DETYRIMI I KONFIDENCIALITETIT	19
Neni 17. DETYRIMI PËR TË RAPORTUAR	19
Neni 18. DETYRIMI PËR TË BASHKËPUNUAR	20
<i>Nën-seksioni 2: Konfliktet e interesit, përfitimet financiare dhe mbrojtja e të drejtave personale</i>	21
Neni 19. KONFLIKTET E INTERESIT	21
Neni 20. OFRIMI DHE PRANIMI I DHURATAVE OSE PËRFITIMEVE TË TJERA	22
Neni 21. KOMISIONI	23
<i>Nën-seksioni 3: Mashtrimi, falsifikimi, shpërdorimi i detyrës, bastet dhe lojërat e fatit</i>	24
Neni 22. MASHTRIMI DHE FALSIFIKIMI	24
Neni 23. ABUZIMI I POZITËS	24
Neni 24. PËRFSHIRJA NË BASTE, LOJËRA FATI OSE AKTIVITETE TË NGJASHME	24

<i>Nën-seksioni 4: Rryshfeti, keqpërdorimi i fondeve dhe manipulimi i ndeshjeve</i>	25
Neni 25. RYSHFETI	25
Neni 26. KEQPËRDORIMI I FONDEVE	26
Neni 27. MANIPULIMI I NDESHJEVE OSE AKTIVITETETEVERE TË FUTBOLLIT	26
PJESA III. ORGANIZIMI DHE PROCEDURA	28
KAPITULLI I: ORGANIZIMI	28
Seksioni 1: <i>Kompetenca e Komisionit të Etikës</i>	28
Neni 28. KOMPETENCA E KOMISIONIT TË ETIKËS	28
Seksioni 2: <i>Rregullat e përbashkëta për hetimin dhe gjykimin</i>	29
Neni 29. PËRBËRJA E KOMISIONIT TË ETIKËS	29
Neni 30. ZËVENDËSIMI	29
Neni 31. SEKRETARIATET	29
Neni 32. PAVARËSIA	30
Neni 33. TËRHEQJA DHE SHMANGIA E KONFLIKTIT TË INTERESIT	30
Neni 34. KONFIDENCIALITETI	31
KAPITULLI II: PROCEDURA	32
Seksioni 1: <i>Rregullat procedurale</i>	32
<i>Nën-seksioni 1: Rregullat e përgjithshme</i>	32
Neni 35. PALËT	32
Neni 36. PËRFAQËSIMI	32

Neni 37. DËSHTIMI PËR TË BASHKËPUNUAR	33
Neni 38. GJUHËT E PËRDORURA NË PROCEDURË	33
Neni 39. NJOFTIMI I VENDIMEVE DHE DOKUMENTEVE TË TJERA	33
Neni 40. EFEKTI I VENDIMEVE	34
<i>Nën-seksioni 2: Prova</i>	<i>34</i>
Neni 41. LLOJET E NDRYSHME TË PROVËS	34
Neni 42. PJESËMARRËS ANONIMË NË PROCEDURË	35
Neni 43. IDENTIFIKIMI I PJESËMARRËSVE ANONIMË NË PROCEDURË	36
Neni 44. PROVAT E PAPANUESHME	36
Neni 45. VLERËSIMI I PROVËS	36
Neni 46. STANDARDI I PROVËS	36
Neni 47. BARRA E PROVËS	37
<i>Nën-seksioni 3: Afatet kohore</i>	<i>37</i>
Neni 48. FILLIMI DHE MBARIMI I AFATIT KOHOR	37
Neni 49. PAJTUESHMËRIA	37
Neni 50. SHTYRJA	38
<i>Nën-seksioni 4: Pezullimi i procedurave</i>	<i>38</i>
Neni 51. PEZULLIMI OSE VAZHDIMI I PROCEDURAVE	38
<i>Nën-seksioni 5: Shpenzimet procedurale</i>	<i>39</i>
Neni 52. SHPENZIMET PROCEDURALE	39
Neni 53. SHPENZIMET PROCEDURALE NË RAST TË MBYLLJES SË PROCEDURËS OSE SHFAJËSIMIT	39
Neni 54. SHPENZIMET PROCEDURALE NËSE VENDOSËN DËNIME	39
Neni 55. SHPENZIMET E TJERA GJYQËSORE	40

Seksioni 2: Procedurat e hetimit	40
<i>Nën-seksioni 1: Procedurat paraprake</i>	40
Neni 56. E DREJTA PËR TË PARASHTRUAR ANKESA	40
Neni 57. HETIMET PARAPRAKE	40
Neni 58. HAPJA E PROCEDURAVE HETIMORE	41
<i>Nën-seksioni 2: Fillimi dhe zhvillimi i procedurave hetimore</i>	41
Neni 59. FILLIMI I HETIMIT	41
Neni 60. DETYRAT DHE KOMPETENCAT E OFICERIT TË INTEGRITETIT	41
Neni 61. KRYERJA E PROCEDURAVE	42
Neni 62. KOMPETENCAT E SHEFIT TË HETIMIT	42
<i>Nën-seksioni 3: Përfundimi i procedurave hetimore</i>	43
Neni 63. PËRFUNDIMI I PROCEDURAVE HETIMORE	43
Neni 64. RAPORTI PËRFUNDIMTAR	43
Neni 65. PROCESI I PRANIMIT TË FAJËSISË (ZBATIMI I NJË DËNIMI ME PËLQIMIN E NDËRSJELLË)	44
Seksioni 3: Procedurat Gjyqësore	45
<i>Nën-seksioni 1: Fillimi dhe zhvillimi i procedurave</i>	45
Neni 66. DETYRAT DHE KOMPETENCAT E KOMISIONIT TË ETIKËS	45
Neni 67. PROCEDURAT GJYQËSORE	45
Neni 68. JURIDIKSIONI I KRYETARIT TË KOMISIONIT TË ETIKËS SI GJYQITAR I VETËM	46
Neni 69. E DREJTA PËR T’U DËGJUAR	46
Neni 70. REFUZIMI I PROPOZIMEVE PËR PRANIMIN E PROVAVE	46

<i>Nën-seksioni 2: Përbërja, seancat dëgjimore</i>	47
Neni 71. PËRBËRJA E PANELIT	47
Neni 72. SEANCAT, PARIMET	47
Neni 73. SEANCAT, PROCEDURAT	48
<i>Nën-seksioni 3: Shqyrtimet, vendimet</i>	48
Neni 74. SHQYRTIMET	48
Neni 75. MARRJA E VENDIMIT	49
Neni 76. VENDIMI I ARSYETUAR	49
Neni 77. FORMA DHE PËRMBAJTJA E VENDIMIT	50
Neni 78. EKZEKUTIMI I VENDIMEVE	50
<i>Seksioni 4: Ankimi dhe rishikimi</i>	50
Neni 79. ANKIMIMI	50
Neni 80. GJYKATA E ARBITRAZHIT PËR SPORT (CAS/TAS)	51
Neni 81. RISHIKIMI	51
<i>Seksioni 5: Dënimet e përkohshme</i>	51
Neni 82. KUSHTET, JURIDIKSIONI, PROCEDURA	51
Neni 83. KOHËZGJATJA	52
Neni 84. PËRJASHTIMI NGA PËRGJEGJËSIA	52
PJESA IV: DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE	53
Neni 85. MIRATIMI DHE ZBATIMI	53

Hyrje

FSHF është përgjegjëse për mbrojtjen e integritetit dhe reputacionit të futbollit në Republikën e Shqipërisë dhe përpiqet vazhdimisht të mbrojë imazhin e futbollit, dhe veçanërisht atë të FSHF-së, nga cënimi ose dëmi që mund të shkaktohet si rezultat i metodave dhe praktikave të paligjshme, anti sportive ose jo-etike. Në lidhje me këtë, Kodi i mëposhtëm pasqyron parimet e Kodit të Sjelljes së FSHF-s, i cili përcakton vlerat thelbësore më të rëndësishme për sjelljen brenda FSHF-s si dhe me palët e jashtme. Sjellja e personave të lidhur me këtë Kod do të pasqyrojë faktin që ata respektojnë parimet dhe objektivat e FSHF-s dhe anëtarëve të saj në çdo mënyrë dhe distancohen nga çdo sjellje, veprim apo mos veprim që mund të jetë e dëmshme për këto qëllime dhe objektiva. Ata do të respektojnë rëndësinë e besnikërisë së tyre ndaj FSHF-së dhe anëtarëve të saj dhe do t'i përfaqësojnë ato dhe do të sillen kundrejt tyre me ndershmëri, dinjitet, respekt dhe integritet. Ata do të respektojnë gjithashtu vlerën thelbësore të lojës së drejtë në çdo aspekt të funksioneve të tyre.

Përkufizimet

Për qëllimet e këtij Kodi, kushtet e përcaktuara më poshtë përkufizohen si në vijim:

1. **FSHF:** Federata Shqiptare e Futbollit.
2. **Zyrtar:** çdo anëtar i bordit (duke përfshirë anëtarët e Këshillit), anëtar i komitetit, arbitër, asistent i arbitrit, trajneri ose ndonjë person tjetër përgjegjës për çështje teknike, mjekësore ose administrative në FSHF ose në shoqatat apo klubet anëtare, ligë ose pjesëmarrës në aktivitet, si dhe të gjithë subjektet e tjerë të detyruar të zbatojnë Statutet e FSHF-s (përveç lojtarëve dhe ndërmjetësve).
3. **Subjekt anëtar:** një shoqatë apo klub futbollit e cila është anëtare e FSHF.
4. **Pjesëmarrës në aktivitet:** çdo subjekt tjetër që për shkak të rregulloreve merr pjesë në aktivitetet e FSHF pa qenë anëtar.
5. **Ndërmjetësi:** një person fizik ose juridik, i cili me pagesë ose pa pagesë, përfaqëson lojtarët dhe/ose klubet në negociata me qëllim lidhjen e kontratës së punës ose përfaqëson klubet në negociata me qëllim lidhjen e marrëveshjes së transferimit.
6. **Lojtari:** çdo lojtar futbollit që aktivizohet me një klub apo shoqatë anëtare apo pjesëmarrëse në aktivitetet e organizuara nga FSHF.
7. **Palë e lidhur:** çdo palë e lidhur me subjektet që zbatojnë Kodin do të konsiderohet palë e lidhur nëse plotëson një ose më shumë nga kriteret e mëposhtme:
 - (a) përfaqësues dhe/ose punonjës;
 - (b) bashkëshort dhe/ose bashkëjetues;
 - (c) individ që bën pjesë në familje, pavarësisht nga marrëdhënia personale;

- (d) anëtar tjetër i familjes me të cilin ata kanë një marrëdhënie të ngushtë brenda një shkalle të tretë;
 - (e) person juridik, partneritet dhe çdo institucion tjetër fiduciar, nëse personi i lidhur nga ky Kod ose personi që merr një avantazh të parregullt në mënyrë alternative:
 - (i) mban një pozicion drejtues brenda atij subjekti, partneriteti ose institucioni fiduciar;
 - (ii) kontrollon në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë subjektin, partneritetin ose institucionin fiduciar;
 - (iii) është përfitues i subjektit, partneritetit ose institucionit fiduciar;
 - (iv) kryen shërbime në emër të subjektit, partneritetit ose institucionit fiduciar, pavarësisht ekzistencës së një kontrate formale.
- 8. Organizimet e FSHF-së:** çdo organizim, duke përfshirë por pa u kufizuar në Asambleenë e Përgjithshme të FSHF-së, në mbledhjet e Komitetit Ekzekutiv, në kompeticionet e FSHF-s, si dhe në çdo ngjarje tjetër që është brenda autoritetit të FSHF-s ose organizohet nga FSHF.
- 9. Komisioni i Etikës:** Referencat për Komisionin e Etikës në këtë Kod janë sipas parashikimeve statutore.

Shënim: Termat që i referohen personave fizikë janë të zbatueshme për të dyja gjinitë.

Çdo term në njëjës zbatohet për shumësin dhe anasjelltas. Zbatohet gjithashtu seksioni i përkufizimeve në Statutet e FSHF-s.

PJESA I. QËLLIMI I ZBATIMIT

Neni 1. Qëllimi i zbatimit

Ky Kod do të zbatohet për çdo sjellje, veprim apo mos veprim, përveç atyre të parashikuara në mënyrë specifike nga rregulloret e tjera dhe që lidhen me fushën e lojës që dëmtojnë integritetin dhe reputacionin e futbollit dhe në veçanti sjelljen e paligjshme, imorale dhe jo-etike të personave të mbuluar sipas nenit 2 të këtij Kodi.

Neni 2. Subjektet e kodit

1. Janë subjekt i këtij kodi sa vijon:
 - a. të gjitha shoqatat apo subjektet juridik të anëtarësuar në FSHF dhe zyrtarët e tyre (dmth. të gjithë subjektet e caktuar nga një anëtar për të ushtruar një funksion të caktuar);
 - b. të gjithë klubet pjesëmarrës në aktivitetet e organizuara nga FSHF dhe zyrtarët e tyre (dmth. të gjithë subjektet e caktuar nga një klub për të ushtruar një funksion të caktuar);
 - c. të gjithë zyrtarët e ndeshjes;
 - d. të gjithë lojtarët;
 - e. të gjithë subjektet e zgjedhur, miratuar ose caktuar nga FSHF për të ushtruar një funksion të caktuar.
2. Subjektet dhe individët e mësipërm i nënshtrohen kompetencave të Komisionit të Etikës. Ata janë të detyruar të njohin dhe zbatojnë statutet, rregulloret, direktivat dhe vendimet e FSHF-së, si dhe Ligjet e Lojës të nxjerra nga Bordi Ndërkombëtar i Shoqatës së Futbollit (IFAB).

Neni 3. Zbatimi në kohë

Ky Kod zbatohet për çdo sjellje që ka ndodhur, përfshirë edhe para miratimit të këtij Kodi. Një individ mund të dënohet për shkelje të këtij Kodi vetëm nëse sjellja përkatëse është në kundërshtim me Kodin e zbatueshëm në kohën që ka ndodhur. Dënimi nuk mund të tejkalojë dënimet maksimale të disponueshme sipas Kodit të zbatueshëm në atë kohë.

Neni 4. Qëllimi i Kodit, mosveprimet, porosinë, doktrina dhe jurisprudenca

1. Ky Kod zbatohet ndaj çdo subjekti të cilit i referohen përmbajtja ose kuptimi i dispozitave të tij.
2. Për atë që nuk është parashikur në këtë Kod në lidhje me rregullat procedurale, dhe në rast dyshimi lidhur me interpretimin e Kodit, Komisioni i Etikës do të vendosë në përputhje me udhëzimet e Komitetit Ekzekutiv të FSHF-s.
3. Gjatë të gjitha veprimtarive të tij, Komisioni i Etikës mund të mbështetet në precedentët dhe parimet e vendosura tashmë nga doktrina sportive dhe jurisprudenca.

Neni 5. Ndarja e Komisionit të Etikës, ndarja e procedurave

1. Procedurat përpara Komisionit të Etikës përcillen nga Oficeri i Integritetit.
2. Procedura e Komisionit të Etikës përbëhet nga faza hetimore dhe faza e gjykimit.

PJESA II. FUSHËVEPRIMI I APLIKIMIT MATERIAL

SEKSIONI 1: *Parashikimi i dënimeve*

Neni 6. Parashikimi i dënimeve

1. Komisioni i Etikës mund të shpallë dënimet e përshkruara në këtë Kod, në Kodin e Disiplinës së FSHF-së dhe në Statutin e FSHF-së.
2. Përveç rasteve kur është parashikuar ndryshe, shkeljet e këtij Kodi i nënshtrohen dënimeve të përcaktuara në të, qofshin këto veprime apo mosveprime, pavarësisht nëse janë kryer me dashje ose nga pakujdesia, nëse shkelja përbën veprim apo veprim të ngelur në tentativë, dhe nëse palët kanë vepruar si ekzekutor, bashkëpunëtor ose nxitës.

SEKSIONI 2: *Masat disiplinore*

Neni 7. Lloji i dënimeve

1. Shkeljet e këtij Kodi nga subjektet e lidhur me të, dënohen me një ose më shumë nga dënimet e parashikuara nga Kodi i Disiplinës Sportive.

Neni 8. Pezullimi i pjesshëm i Dënimeve

1. Me kërkesë të palës përkatëse, Komisioni i Etikës mund të vendosë pezullimin e dënimit të parashikuar në nenin 7(1) të këtij Kodi, për jo më shumë se një të tretën e kohëzgjatjes totale të dënimit të dhënë. Periudha e provës do të jetë nga një deri në pesë vjet.
2. Nëse personi që përfiton nga një dënim i pezulluar kryen ndonjë shkelje tjetër të këtij Kodi gjatë periudhës së provës, pezullimi do

të revokohet automatikisht dhe dënimi fillestar zbatohet plotësisht dhe shtohet dënimi i vendosur për shkeljen e re.

SEKSIONI 3: Përcaktimi i dënimit

Neni 9. Rregulla të përgjithshme

1. Gjatë vendosjes së dënimeve, Komisioni i Etikës do të marrë parasysh të gjithë faktorët përkatës në çështje, duke përfshirë natyrën e shkeljes; interesin për të penguar shkeljen; ndihmën e shkelësit dhe bashkëpunimin me Komisionin e Etikës; motivin; rrethanat; shkallën e fajit të shkelësit; shkallën në të cilën shkelësi pranon përgjegjësinë dhe nëse personi lehtëson fajin e tij duke kthyer përfitimin e marrë, për aq sa është e mundur.
2. Në rast të rrethanave lehtësuese dhe nëse konsiderohet e përshtatshme duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit, Komisioni i Etikës mund të aplikojë më pak se dënimi minimal dhe/ose të vendosë për uljen e dënimeve alternative sipas nenit 7, paragrafi i parë.
3. Për aq sa nuk parashikohet ndryshe në këtë Kod, Komisioni i Etikës do të vendosë fushëveprimin dhe kohëzgjatjen e çdo dënimi.
4. Dënimet mund të kufizohen në një ose në një ose më shumë kategori specifike të ndeshjeve ose aktiviteteve.
5. Komisioni i Etikës mund t'i rekomandojë organit përgjegjës të FSHF-së që të ndajë informacionin mbi një çështje me autoritetet e duhura publike.

Neni 10. Shkelja e përsëritur

Shkeljet e përsëritura do të konsiderohen si rrethana rënduese, duke i lejuar Komisionit të Etikës të tejkalojë kufirin maksimal të parashikuar për shkelje të rregullave përkatëse, siç përcaktohet në këtë Kod.

Neni 11. Shkelje të njëkohshme

Kur është kryer më shumë se një shkelje, dënimi përveç dënimeve monetare bazohet në shkelje më serioze dhe rritet deri në një të tretën sipas rastit, në varësi të rrethanave specifike.

SEKSIONI 4: Afatet e Parashkrimit

Neni 12. Afatet e parashkrimit

1. Si rregull i përgjithshëm, shkeljet e dispozitave të këtij Kodi parashkruhen pas një periudhe prej pesë vjetësh.
2. Marrja e rryshfetit dhe manipulimi i ndeshjeve të futbollit nuk parashkruhet.
3. Afati i parashkrimit, kur është i zbatueshme, pezullohet kur procedimi hapet zyrtarisht kundër një personi të lidhur nga ky kod.
4. Në rast të shkeljeve të përsëritura, periudha e kufizimit siç përshkruhet më sipër fillon vetëm pas përfundimit të shkeljes së fundit të përsëritur.

SEKSIONI 5: Rregullat e sjelljes

Nën-seksioni 1: Detyrat

Neni 13. Detyrat e përgjithshme

1. Subjektet e lidhur me këtë Kod duhet të jenë të vetëdijshëm për rëndësinë e detyrave të tyre dhe detyrimet e përgjegjësitë që rrjedhin nga këto detyra. Në veçanti, subjektet e lidhur me këtë Kod duhet të përmbushin dhe ushtrojnë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre me seriozitet, veçanërisht në lidhje me çështjet që lidhen me financat dhe integritetin e garës.

2. Subjektet e lidhur me këtë Kod do të respektojnë kornizën rregullatore të FSHF-s në masën që zbatohet për ata.
3. Subjektet e lidhur me këtë Kod do të vlerësojnë ndikimin që sjellja e tyre mund të ketë në reputacionin e FSHF-s dhe prandaj duhet të sillen në mënyrë dinjitoze dhe etike e të veprojnë me besueshmëri të plotë dhe integritet në çdo kohë.
4. Subjektet e lidhur me këtë Kod duhet të distancohen nga çdo veprimtari ose sjellje ose ndonjë veprim apo mosveprim në tentativë që mund të shkaktojë shfaqjen ose dyshimin e sjelljes së pahijshme siç përshkruhet në seksionet që vijojnë.
5. Shkelja e këtij neni do të dënohet me një gjobë të përshtatshme prej të paktën 100,000 (njëqindmijë) Lekë ose me ndalimin e pjesëmarrjes në ndonjë aktivitet të lidhur me futbollin për një periudhë maksimale prej dy vitesh.

Neni 14. Detyrimi i neutralitetit

1. Në marrëdhëniet me institucionet qeveritare, subjektet anëtare dhe pjesëmarrësit në aktivitete, subjektet e lidhur me këtë Kod, përveç zbatimit të rregullave themelore të nenit 13, duhet të mbeten politikisht neutral, në përputhje me parimet dhe objektivat e FSHF-s, dhe të veprojnë në një mënyrë të pajtueshme me funksionin dhe integritetin e tyre.
2. Shkelja e këtij neni do të dënohet me një gjobë të përshtatshme prej të paktën 100,000 (njëqindmijë) Lekë si dhe me ndalimin e pjesëmarrjes në ndonjë aktivitet të lidhur me futbollin për një periudhë maksimale prej dy vjetësh.

Neni 15. Detyrimi i besnikërisë

1. Subjektet e lidhur me këtë Kod kanë detyrimin e mirëbesimit ndaj FSHF-s, subjekteve anëtare dhe pjesëmarrësve në aktivitete.

2. Shkelja e këtij neni do të dënohet me një gjobë të përshtatshme prej të paktën 100,000 (njëqindmijë) Lekë si dhe me ndalimin e pjesëmarrjes në ndonjë aktivitet të lidhur me futbollin për një periudhë maksimale prej dy vjetësh.

Neni 16. Detyrimi i konfidencialitetit

1. Në varësi të funksionit të tyre, informacioni i një natyre konfidenciale që i zbulohet personave të lidhur me këtë Kod gjatë kryerjes së detyrave të tyre do të trajtohet si konfidencial ose sekret nga ata, nëse informacioni jepet me mirëkuptimin ose komunikimin e konfidencialitetit dhe është në përputhje me parimet e FSHF-s.
2. Detyrimi për të respektuar konfidencialitetin vazhdon edhe pas përfundimit të çfarëdo marrëdhënieje që e bën një person subjekt të këtij Kodi.
3. Shkelja e këtij neni do të dënohet me një gjobë të përshtatshme prej të paktën 100,000 (njëqindmijë) Lekë si dhe me ndalimin e pjesëmarrjes në ndonjë aktivitet të lidhur me futbollin për një periudhë maksimale prej dy vjetësh.

Neni 17. Detyrimi për të raportuar

1. Subjektet e lidhur me këtë Kod, të cilët vijnë në dijeni për çdo shkelje të këtij Kodi, do të informojnë me shkrim drejtpërdrejt sekretariatit dhe/ose kryetarit e Komisionit të Etikës.
2. Dështimi për të raportuar shkeljet e tilla do të dënohet me një gjobë të përshtatshme prej të paktën 100,000 (njëqindmijë) Lekë si dhe me ndalimin e pjesëmarrjes në ndonjë aktivitet të lidhur me futbollin për një periudhë maksimale prej dy vjetësh.

Neni 18. Detyrimi për të bashkëpunuar

1. Subjektet e lidhur me këtë Kod duhet të asistojnë dhe bashkëpunojnë në mënyrë të sigurtë, plotësisht dhe në mirëbesim me Komisionin e Etikës në çdo kohë, pavarësisht nëse ata janë të përfshirë në një çështje të caktuar si palë, si dëshmitar ose në ndonjë rol tjetër. Kjo kërkon, ndër të tjera, pajtueshmërinë e plotë me kërkesat e Komisionit të Etikës, duke përfshirë por pa u kufizuar kërkesa për sqarimin e fakteve; dhënien e dëshmisë me gojë ose me shkrim; dhënien e informacionit, dokumenteve ose materialeve të tjera; dhe të zbulojë detajet në lidhje me të ardhurat dhe financat, nëse Komisioni i Etikës e konsideron të nevojshme.
2. Subjektet e lidhur me këtë Kod, të cilët kërkohet të bashkëpunojnë me Komisionin e Etikës në një rast specifik, pavarësisht nëse ata janë të përfshirë si palë, si dëshmitare ose në ndonjë rol tjetër, do të trajtojnë informacionin e dhënë dhe përfshirjen e tyre rigorozisht në mënyrë konfidenciale, përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Komisioni i Etikës.
3. Subjektet e lidhur me këtë Kod nuk duhet të ndërmarrin ndonjë veprim që ka gjasa të pengojë, shmangë, parandalojë ose përndryshe të ndërhyjë në ndonjë procedurë të Komisionit të Etikës aktuale ose të mundshme.
4. Në lidhje me ndonjë procedurë të Komisionit të Etikës aktuale ose të mundshme, subjektet e lidhur me këtë Kod nuk do të fshehin ndonjë fakt material; të bëjnë ndonjë deklaratë ose përfaqësim materialisht të rremë ose mashtrues; ose të paraqesin ndonjë informacion të paplotë, materialisht të rremë ose mashtrues ose materiale të tjera.
5. Subjektet e lidhur me këtë Kod nuk do të ngacmojnë, frikësojnë, kërcënojnë ose nuk do të hakmerren kundër dikujt për ndonjë arsye që lidhet me ndihmën aktuale ose potencialin e atij personi ose me bashkëpunimin me Komisionin e Etikës.

6. Shkelja e këtij neni do të dënohet me një gjobë të përshtatshme prej të paktën 100,000 (njëqindmijë) Lekë si dhe me ndalimin e pjesëmarrjes në ndonjë aktivitet të lidhur me futbollin për një periudhë maksimale prej dy vjetësh.

Nën-seksioni 2: Konfliktet e interesit, përfitimet financiare dhe mbrojtja e të drejtave personale

Neni 19. Konfliktet e interesit

1. Subjektet e lidhur me këtë Kod nuk do të kryejnë detyrat e tyre (në veçanti, përgatitjen ose pjesëmarrjen në marrjen e një vendimi) në situata në të cilat një konflikt ekzistues ose potencial i interesit mund të ndikojë në një performancë të tillë.
Konflikti i interesit lind nëse personi i lidhur me këtë Kod ka ose duket se ka interesa dytësore që mund të ndikojnë në aftësinë e tij për të kryer detyrat e tij me integritet në një mënyrë të pavarur dhe të qëllimshme. Interesat dytësore përfshijnë, por nuk kufizohen në fitimin e ndonjë avantazhi të mundshëm për subjektet e përfshirë nga ky Kod ose palët e lidhura siç përcaktohet në këtë Kod.
2. Para zgjedhjes, emërimit ose punësimit, subjektet e lidhur me këtë Kod do të zbulojnë çdo marrëdhënie dhe interesa që mund të çojnë në situata të konfliktit të interesave në kontekstin e aktiviteteve të tyre të ardhshme.
3. Subjektet e lidhur me këtë Kod nuk duhet të kryejnë detyrat e tyre (në veçanti përgatitjen ose pjesëmarrjen në marrjen e një vendimi) në situata, në të cilat ekziston rreziku që një konflikt interesi mund të ndikojë në një performancë të tillë. Çdo konflikt i tillë do të zbulohet menjëherë dhe do t'i njoftohet organizatës për të cilën personi i lidhur me këtë Kod kryen detyrat e tij.
4. Shkelja e këtij neni do të dënohet me një gjobë të përshtatshme prej të paktën 100,000 (njëqindmijë) Lekë si dhe me ndalimin e pjesëmarrjes në ndonjë aktivitet të lidhur me futbollin për një

periudhë maksimale prej dy vjetësh. Në raste serioze dhe/ose në rast përsëritjeje, ndalimi i pjesëmarrjes në ndonjë aktivitet të lidhur me futbollin mund të shpallet për një maksimum prej pesë vitesh.

Neni 20. Ofrimi dhe pranimi i dhuratave ose përfitimeve të tjera

1. Subjektet e lidhur me këtë Kod mund të ofrojnë ose pranojnë dhurata ose përfitime të tjera për dhe nga subjektet brenda ose jashtë FSHF-s, ose në bashkëpunim me ndërmjetësuesit ose palët e ndërlidhura siç përcaktohet në këtë Kod, vetëm kur dhuratat ose përfitimet e tilla:
 - (a) kanë vlerë simbolike ose të parëndësishme;
 - (b) nuk ofrohen ose pranohen si një mënyrë për të ndikuar subjektet e lidhur me këtë Kod për të ekzekutuar ose mos kryer një akt që lidhet me aktivitetet e tyre zyrtare ose bie në diskrecionin e tyre;
 - (c) nuk ofrohen ose pranohen në kundërshtim me detyrat e personave të lidhur me këtë Kod;
 - (d) nuk krijojnë ndonjë avantazh të parave ose avantazhe të tjera; dhe
 - (e) nuk krijojnë konflikt interesi.

Çdo dhuratë ose përfitime të tjera që nuk plotësojnë të gjitha këto kritere janë të ndaluara.

2. Në rast dyshimi, dhurata ose përfitime të tjera nuk do të pranohen, jepen, ofrohen, premtohen, merren, kërkohen ose nxiten. Në të gjitha rastet, subjektet e lidhur me këtë Kod nuk do të pranojnë, japin, ofrojnë, premtojnë, marrin, kërkojnë ose nxiten nga askush brenda ose jashtë FSHF-s, ose në bashkëpunim me ndërmjetësuesit ose palët e lidhura siç përcaktohet në këtë Kod, para në asnjë shumë ose formë. Nëse refuzimi i dhuratës ose përfitimit do t'i ofendonte dhënësit në bazë të normave kulturore, subjektet e

lidhur me këtë Kod mund ta pranojnë dhuratën ose përfitimin në emër të organizatës së tyre përkatëse dhe do ta raportojnë atë dhe ta dorëzojnë, aty ku është e zbatueshme, menjëherë pranë organit kompetent.

3. Shkelja e këtij neni do të dënohet me një gjobë të përshtatshme prej të paktën 100,000 (njëqindmijë) Lekë si dhe me ndalimin e pjesëmarrjes në ndonjë aktivitet të lidhur me futbollin për një periudhë maksimale prej dy vjetësh. Çdo shumë e marrë padrejtësisht do të përfshihet në llogaritjen e gjobës. Përveç gjobës, dhurata ose përfitimi i marrë padrejtësisht duhet të kthehen, nëse është e zbatueshme. Në raste serioze dhe/ose në rast përsëritjeje, ndalimi i pjesëmarrjes në ndonjë aktivitet të lidhur me futbollin mund të shpallet për një maksimum prej pesë vitesh.

Neni 21. Komisioni

1. Përveç nëse nuk mbulohet nga një marrëveshje e mirëfilltë tregtare, subjektet e lidhur me këtë Kod nuk do të pranojnë, japin, ofrojnë, premtojnë, marrin, kërkojnë ose nxisin komision për veten apo palët e treta për negociimin e marrëveshjeve ose kryerjen e veprimeve të tjera në lidhje me detyrat e tyre.
2. Shkelja e këtij neni do të dënohet me një gjobë të përshtatshme prej të paktën 100,000 (njëqindmijë) Lekë si dhe me ndalimin e pjesëmarrjes në ndonjë aktivitet të lidhur me futbollin për një periudhë maksimale prej dy vjetësh. Çdo shumë e marrë padrejtësisht do të përfshihet në llogaritjen e gjobës. Në raste serioze dhe/ose në rast përsëritjeje, ndalimi i pjesëmarrjes në ndonjë aktivitet të lidhur me futbollin mund të shpallet për një maksimum prej pesë vitesh.

Nën-seksioni 3: Mashtrimi, falsifikimi, shpërdorimi i detyrës, bastet dhe lojërat e fatit

Neni 22. Mashtrimi dhe falsifikimi

1. Subjektet e lidhur me këtë Kod nuk lejohen të falsifikojnë një dokument, të ndryshojnë një dokument autentik ose të përdorin një dokument të ndryshuar ose të falsifikuar.
2. Shkelja e këtij neni do të dënohet me një gjobë të përshtatshme prej të paktën 200,000 (dyëqindmijë) Lekë si dhe me ndalimin e pjesëmarrjes në ndonjë aktivitet të lidhur me futbollin për një minimum prej dy vjetësh.

Neni 23. Abuzimi i pozitës

1. Subjektet e lidhur me këtë Kod nuk do të keqpërdorin pozitën e tyre në asnjë mënyrë, veçanërisht për të përfituar përfitime private.
2. Shkelja e këtij neni do të dënohet me një gjobë të përshtatshme prej të paktën 200,000 (dyqindmijë) Lekë si dhe me ndalimin e pjesëmarrjes në ndonjë aktivitet të lidhur me futbollin për një minimum prej dy vjetësh. Dënimet do të rriten në përputhje me rrethanat kur personi ka një pozitë të lartë në futboll, si dhe në lidhje me rëndësinë dhe shumën e avantazhit të marrë.

Neni 24. Përfshirja në baste, lojëra fati ose aktivitete të ngjashme

1. Personave të lidhur me këtë Kod do t'i ndalohet pjesëmarrja, qoftë drejtpërdrejt ose tërthorazi, në baste, lojëra fati, lotari ose ngjarje të ngjashme ose transaksione që lidhen me ndeshje futbollit ose gara dhe/ose ndonjë aktivitet tjetër futbollit.
2. Subjektet e lidhur me këtë Kod nuk duhet të kenë interesa, drejtpërdrejt ose tërthorazi (nëpërmjet ose në bashkëpunim me

palët e treta), në entitete, kompani, organizata etj. që nxisin, ndërmjetësojnë, rregullojnë ose kryejnë baste, lojëra fati, lotari apo ngjarje ose transaksione të ngjashme që lidhen me ndeshjet dhe garat e futbollit. Interesat përfshijnë marrjen e ndonjë avantazhi të mundshëm për subjektet e lidhur me këtë Kod dhe/ose palët e lidhura.

3. Me kusht që sjellja përkatëse të mos përbëjë një tjetër shkelje të këtij Kodi, shkelja e këtij neni do të dënohet me një gjobë të përshtatshme prej të paktën 500,000 (pesëqindmijë) Lekë dhe një ndalim për të marrë pjesë në ndonjë aktivitet të lidhur me futbollin për një periudhë minimale prej tre vitesh. Çdo shumë e marrë padrejtësisht do të përfshihet në llogaritjen e gjobës.

Nën-seksioni 4: Ryshfeti, keqpërdorimi i fondeve dhe manipulimi i ndeshjeve

Neni 25. Ryshfeti

1. Subjektet e lidhur me këtë Kod nuk do të pranojnë, japin, ofrojnë, premtojnë, marrin, kërkojnë ndonjë avantazh personal ose përfitim tjetër në mënyrë që të marrin ose bëjnë tregti ose ndonjë avantazh tjetër nga secili brenda ose jashtë FSHF-s. Veprime të tilla janë të ndaluara pavarësisht nëse janë kryer në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nëpërmjet ose në lidhje me palët e treta. Në veçanti, subjektet e lidhur me këtë Kod nuk do të pranojnë, japin, ofrojnë, premtojnë, marrin, kërkojnë ndonjë avantazh personal ose ndonjë avantazh tjetër për ekzekutimin ose mos kryerjen e një akti që lidhet me aktivitetet e tyre zyrtare dhe që është në kundërshtim me detyrat e tyre.
2. Subjektet e lidhur me këtë Kod duhet të përmbahen nga çdo aktivitet ose sjellje që mund të shkaktojë shfaqjen ose dyshimin për shkelje të këtij neni.
3. Shkelja e këtij neni do të dënohet me një gjobë të përshtatshme prej të paktën 500,000 (pesëqindmijë) Lekë dhe një ndalim

për të marrë pjesë në ndonjë aktivitet të lidhur me futbollin për një periudhë minimale prej tre vitesh. Çdo shumë e marrë padrejtësisht do të përfshihet në llogaritjen e gjobës. Dënimet do të rriten në përputhje me rrethanat kur personi ka një pozitë të lartë në futboll, si dhe në lidhje me rëndësinë dhe shumën e avantazhit të marrë.

Neni 26. Keqpërdorimi i fondeve

1. Subjektet e lidhur me këtë Kod nuk duhet të shpërdorjnë fondet e FSHF-së, subjekteve anëtare, ligave ose klubeve, qoftë direkt ose indirekt, nëpërmjet ose në bashkëpunim me palët e treta.
2. Shkelja e këtij neni do të dënohet me një gjobë të përshtatshme prej të paktën 100,000 (njëqindmijë) Lekë, si dhe një ndalim për të marrë pjesë në çdo aktivitet të lidhur me futbollin për një minimum prej pesë vjetësh. Shuma e fondeve të keqpërdorura do të përfshihet në llogaritjen e gjobës. Dënimet do të rriten në përputhje me rrethanat kur personi ka një pozitë të lartë në futboll, si dhe në lidhje me rëndësinë dhe shumën e avantazhit të marrë.

Neni 27. Manipulimi i ndeshjeve ose aktiviteteve të futbollit

1. Subjektet e lidhur me këtë Kod ndalohen të përfshihen në manipulimin e ndeshjeve ose aktiviteteve të futbollit. Një manipulim i tillë përkufizohet si ndikim ose ndryshim i paligjshëm, drejtpërdrejt ose me një veprim apo mosveprim, i rrjedhës, rezultatit ose ndonjë aspekti tjetër të një ndeshje ose aktiviteti futbollit, pavarësisht nëse sjellja është kryer për përfitime financiare, përparësi sportive ose ndonjë qëllim tjetër. Në veçanti, subjektet e lidhur me këtë Kod nuk do të pranojnë, japin, ofrojnë, premtojnë, marrin, kërkojnë ose nxisin ndonjë avantazh apo përfitim tjetër, në emër të vet apo të një pale të tretë, në lidhje me manipulimin e ndeshjeve ose aktiviteteve të futbollit.

2. Subjektet e lidhur me këtë Kod do t'i raportojnë menjëherë Komisionit të Etikës çdo qasje përsa i përket veprimeve dhe/ose informacioneve që lidhen direkt ose indirekt me manipulimin e mundshëm të një ndeshje ose aktiviteteve futbolli siç përshkruhet më sipër.
3. Komisioni i Etikës do të jetë kompetent për të hetuar dhe gjykuar të gjitha sjelljet e subjekteve anëtare ose pjesëmarrëse në aktivitet që kanë pak ose aspak lidhje me aksionet sportive në fushën e lojës. Kompetenca e Komisionit të Disiplinës për të ndëshkuar këto shkelje, mbetet e pa prekur.
4. Shkelja e këtij neni do të dënohet me një gjobë të përshtatshme prej të paktën 2,000,000 (dymilion) Lekë si dhe me ndalimin e pjesëmarrjes në ndonjë aktivitet të lidhur me futbollin për një minimum prej pesë vjetësh për shkelje të par. 1 dhe një minimum prej dy vjetësh për shkelje të par. 2. Çdo shumë e marrë padrejtësisht do të merret në konsideratë në llogaritjen e gjobës.

KAPITULLI I: ORGANIZIMI

Pjesa III. Organizimi dhe procedura

SEKSIONI 1: Kompetenca e Komisionit të Etikës

Neni 28. Kompetenca e Komisionit të Etikës

1. Komisioni i Etikës ka kompetencë ekskluzive për të hetuar dhe gjykuar sjelljen e të gjithë personave të lidhur me këtë Kod, kur sjellja e tillë:
 - (a) është kryer nga një individ i zgjedhur, emëruar ose caktuar nga FSHF për të ushtruar një funksion;
 - (b) ka të bëjë drejtpërdrejt me detyrat ose përgjegjësitë e tyre lidhur me FSHF-n; ose
 - (c) lidhet me përdorimin e fondeve të FSHF-s.
2. Kur sjellja e tillë ndikon në një shoqatë, apo klub anëtar të FSHF apo që merr pjesë në aktivitet dhe kur sjellja e përmendur nuk lidhet drejtpërdrejt me çështjet e FSHF-s, Komisioni i Etikës ka të drejtë vetëm të hetojë dhe gjykojë rastin kur sjellja në fjalë nuk është hetuar dhe gjykuar dhe/ose nuk mund të pritet që të hetohet dhe gjykohet nga organet përkatëse gjyqësore/disiplinore të shoqatës ose klubit në fjalë.

SEKSIONI 2: Rregullat e përbashkëta për hetimin dhe gjykimin**Neni 29. Përbërja e Komisionit të Etikës**

Përbërja e Komisionit të Etikës duhet të jetë në përputhje me Statutet e FSHF-së.

Neni 30. Zëvendësimi

Nëse kryetari i Komisionit ka pengesë për të vepruar (qoftë për shkak të rrethanave personale apo faktike), ai do të zëvendësohet nga një zëvendëskryetar. Në rast se zëvendëskryetarët gjithashtu pengohen të veprojnë, një anëtar i komisionit do të veprojë si kryetar në bazë të vjetërsisë në punë.

Neni 31. Sekretariatet

1. Sekretariati i përgjithshëm i FSHF-s i siguron Komisionit të Etikës dhe Oficerit të Integritetit një sekretariat me stafin e nevojshëm. Sekretariati do të kujdeset për paraqitjen përkatëse të shkresave të çështje, të cilat duhet të mbahen për të paktën dhjetë vjet.
2. Sekretariati i teknik, nën autoritetin e Oficerit të Integritetit, merr përsipër punën administrative dhe ligjore në lidhje me procedurat dhe siguron mbështetje për kryerjen e detyrave; në veçanti, harton procesverbalin, raportet përfundimtare dhe çdo dokument tjetër të kërkuar.
3. Sekretariati i Komisionit të Etikës, nën autoritetin e kryetarit të trupit gjykues, merr përsipër punën administrative dhe ligjore në lidhje me procedurat dhe siguron mbështetje për Komisionin e Etikës për kryerjen e detyrave të saj; në veçanti, harton procesverbalin dhe çdo dokument tjetër të kërkuar nga kryetari i trupës gjykuese.

Neni 32. Pavarësia

1. Anëtarët e Komisionit të Etikës menaxhojnë hetimet dhe procedurat e tyre dhe marrin vendimet e tyre plotësisht në mënyrë të pavarur dhe shmangin çdo ndikim të palës së tretë.
2. Anëtarët e Komisionit të Etikës dhe anëtarët e tyre të afërt të familjes nuk i përkasin asnjë organi tjetër gjyqësor brenda FSHF-s, Këshillit të FSHF-s ose ndonjë komiteti të përhershëm të FSHF-së;
3. Anëtarët e Komisionit të Etikës nuk i përkasin asnjë organi tjetër të FSHF-s.

Neni 33. Dorëheqja dhe Shmangia e Konfliktit të Interesit

1. Një anëtar i Komisionit të Etikës mund të refuzojë të marrë pjesë në ndonjë hetim ose procedurë gjyqësore lidhur me një çështje ku ekzistojnë baza serioze për të vënë në dyshim paanësinë e tij.
2. Sa më sipër, do të zbatohet në veçanti në rastet e mëposhtme:
 - (a) nëse anëtari në fjalë ka një interes të drejtpërdrejtë në rezultatin e çështjes;
 - (b) nëse anëtari ka një njëanshmëri apo paragjykim personal në lidhje me një palë; ose person, njohuri të dorës së parë të fakteve të diskutueshme të provave materiale në procedurë; ose ka shprehur një mendim, përveçse si pjesë e procedurës në fjalë, lidhur me rezultatin e çështjes; ose kur familja e afërt e anëtarit është palë e çështjes objekt hetimi/gjykimi, është palë në proces ose ka ndonjë interes tjetër që mund të ndikohet në masë të madhe nga rezultati i procesit dhe paanshmëria e tij;
 - (c) nëse anëtari tashmë ka trajtuar çështjen në një funksion tjetër përveç funksionit të tij si anëtar i Komisionit të Etikës.
3. Anëtarët që refuzojnë të marrin pjesë duhet të njoftojnë menjëherë kryetarin.

4. Çdo kërkesë për përjashtim të një anëtari të Komisionit të Etikës që besohet të jetë i njëanshëm duhet të paraqitet brenda pesë ditëve nga identifikimi i arsyeve për mospjesëmarrje, në mungesë të së cilës, një kundërshtim i tillë do të konsiderohet i anuluar. Kërkesa duhet të citojë arsyet dhe, nëse është e mundur, të provohet.
5. Kryetari i Komisionit vendos nëse një kërkesë e tillë është e vlefshme nëse anëtari në fjalë nuk ka refuzuar të marrë pjesë në mënyrë të pavarur. Nëse kërkesa është kundër kryetarit, vendos një nga zëvendëskryetarët.

Neni 34. Konfidencialiteti

1. Anëtarët e Komisionit të Etikës dhe anëtarët e sekretariatit duhet të sigurojnë që çdo gjë që u është zbuluar gjatë detyrës së tyre mbetet konfidenciale, në veçanti, diskutimet dhe të dhënat personale private në përputhje me Rregulloret e FSHF-s për Mbrojtjen e të Dhënave.
2. Komisioni i Etikës, mund të informojë në një formë të përshtatshme dhe/ose nëpërmjet faqes së internetit të FSHF, për arsyet e çdo vendimi dhe/ose mbylljen e çdo hetimi.

KAPITULLI II: PROCEDURA

Pjesa III. Organizimi dhe procedura

SEKSIONI 1: Rregullat procedurale

Nën-seksioni 1: Rregullat e përgjithshme

Neni 35. Palët

Vetëm subjektet apo personat e akuzuar konsiderohen palë.

Neni 36. Përfaqësimi

1. Gjatë çdo marrëdhënieje me Komisionin e Etikës, palët dhe subjektet e tjerë të lidhur me këtë Kod mund të kenë përfaqësim ligjor me shpenzimet e tyre.
2. Palët dhe subjektet e tjerë të lidhur me këtë Kod janë të lirë të zgjedhin avokatin ose përfaqësimin e tyre ligjor.
3. Komisioni i Etikës mund të kërkojë që përfaqësuesit e palëve dhe personave të tjerë të lidhur me këtë Kod të dorëzojnë një autorizim të nënshkruar në mënyrë të rregullt.
4. Komisioni i Etikës mund të kufizojë numrin e përfaqësuesve ligjorë të një pale nëse konsiderohet i tepruar.

Neni 37. Dështimi për të bashkëpunuar

1. Nëse palët ose subjektet e tjerë të lidhur me këtë Kod dështojnë të bashkëpunojnë në çdo mënyrë ose janë të vonuar në përgjigjen e ndonjë kërkesë të Komisionit të Etikës, kryetari i komisionit mundet, pas paralajmërimit të tyre, t'i dënimojë me një shkelje e të nenit 18 të këtij Kodi.
2. Në masën që palët dështojnë të bashkëpunojnë, Oficeri i Integritetit, në përgatitjen e një raporti përfundimtar të bazuar në dosjen në posedim të saj dhe Komisioni i Etikës, në marrjen e një vendimi bazuar në dosjen në posedim, mund të marrë parasysh sjelljen dhe dështimin për të bashkëpunuar si një pagesë shtesë për shkeljen e Nenit 18 të këtij Kodi.

Neni 38. Gjuhët e përdorura në procedurë

1. Gjuha e përdorur në procedurat do të jetë gjuha shqipe.
2. Nëse është e nevojshme, FSHF mund të përdorë shërbimet e një përkthyesi.

Neni 39. Njoftimi i vendimeve dhe dokumenteve të tjera

1. Vendimet dhe dokumentet e tjera duhet të komunikohen dhe të njoftohen me email, dhe mund të pasohen me letër rekomande.
2. Të gjitha palët do të njoftohen për vendimet.
3. Vendimet dhe dokumentet e tjera të destinuara për subjektet e lidhur me këtë Kod mund t'i drejtohen personit drejtpërdrejt dhe/ose klubit apo shoqatës në fjalë, me kusht që t'i dërgohen dokumentet marrësit të synuar. Njoftimet do të konsiderohen se i janë komunikuar si duhet adresuesit përfundimtar nëse dërgohen në klubin apo shoqatën ku ai bën pjesë ose aktivizohet.
4. Njoftimi i një vendimi do të bëhet përmes publikimit në faqen e internetit të FSHF-s kur:

- (a) vendndodhja e palës është e panjohur dhe nuk mund të konstatohet pavarësisht se bëhen kërkime të arsyeshme;
 - (b) shërbimi është i pamundur ose do të çonte në shqetësime të jashtëzakonshme; ose
 - (c) pala nuk ka ofruar mjete kontakti pavarësisht se është udhëzuar ta bëjë këtë.
5. Njoftimi përmes faqes së internetit të FSHF-s konsiderohet i kryer në ditën e publikimit.

Neni 40. Efekti i vendimeve

- 1. Vendimet e miratuara nga Komisioni i Etikës do të hyjnë në fuqi sapo të komunikohen.
- 2. Komisioni i Etikës mund të korrigjojë çdo gabim të dukshëm në çdo kohë.

Nën-seksioni 2: Prova

Neni 41. Llojet e ndryshme të provës

- 1. Mund të paraqitet çdo lloj prove.
- 2. Llojet e provave përfshijnë, në veçanti:
 - (a) dokumentet;
 - (b) raporte nga zyrtarët;
 - (c) deklaratat e palëve;
 - (d) deklaratat e dëshmitarëve;
 - (e) regjistrimet audio dhe video;
 - (f) mendimet e ekspertëve;
 - (g) të gjitha dëshmitë e tjera që vlerësohen të arsyeshme për rastin.
- 3. Gjatë hetimit, ku jepet dëshmi verbale, një dëshmi e tillë mund të jepet personalisht, me telefon ose me video.

Neni 42. Pjesëmarrës anonimë në procedurë

1. Kur dëshmia e një personi në procedurat etike të kryera në përputhje me këtë Kod mund të çojë në kërcënime ndaj personit të tij ose ta vendosë atë ose ndonjë person veçanërisht të afërt me të në rrezik fizik, kryetari i komisionit mund të urdhërojë, ndër të tjera, që:
 - (a) personi mos të identifikohet në praninë e palëve;
 - (b) personi mos të paraqitet në seancë;
 - (c) zëri i personit të shtrembërohet;
 - (d) personi të merret në pyetje jashtë sallës dëgjimore;
 - (e) personi të merret në pyetje me shkrim;
 - (f) të gjitha ose disa nga informacionet që mund të përdoren për të identifikuar personin të përfshihen vetëm në një dosje të veçantë dhe konfidenciale.
2. Nëse nuk ka dëshmi të tjera për të vërtetuar dëshminë e dhënë nga personi në fjalë, dëshmia e tillë mund të përdoret vetëm në kontekstin e vendosjes së dënimeve sipas këtij Kodi nëse:
 - (a) palët si dhe përfaqësuesit e tyre ligjorë kanë pasur mundësinë të parashtrojnë pyetje për personin në fjalë të paktën me shkrim; dhe
 - (b) anëtarët e organit gjyqësor kanë pasur mundësinë të intervistojnë personin përkatës në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe në vetëdijen e plotë të identitetit të tij dhe të vlerësojnë identitetin e tij dhe ta regjistrojnë në tërësi.
3. Masat disiplinore do të vendosen ndaj kujtdo që zbulon identitetin e një personi që i është dhënë anonimati sipas kësaj dispozite ose çdo informacion që mund të përdoret për të identifikuar personin e tillë.

Neni 43. Identifikimi i pjesëmarrësve anonimë në procedurë

1. Për të garantuar sigurinë e tyre, personave që i është dhënë anonimiteti sipas nenit 44 do të identifikohen me dyer të mbyllura në mungesë të palëve. Ky identifikim duhet të kryhet vetëm nga kryetari i Komisionit të Etikës dhe do të regjistrohet në procesverbal që përmban të dhënat personale të personit përkatës.
2. Ky procesverbal nuk i komunikohet palëve.
3. Palët marrin një njoftim të shkurtër, i cili:
 - (a) konfirmon se personi në fjalë është identifikuar zyrtarisht; dhe
 - (b) nuk përmban detaje që mund të përdoren për të identifikuar personin e tillë.

Neni 44. Provat e papranueshme

Prova që është marrë me mjete ose mënyra që përfshijnë shkelje të dinjitetit njerëzor ose që sigurisht nuk shërben për të vërtetuar faktet relevante, do të refuzohet.

Neni 45. Vlerësimi i provave

Komisioni i Etikës do të ketë diskrecionin absolut lidhur me provat që i nënshtrohen gjykimit.

Neni 46. Standardi i provës

Anëtarët e Komisionit të Etikës gjykojnë dhe vendosin në bazë të bindjes së tyre të brendshme.

Neni 47. Barra e provës

Barra e provës në lidhje me shkeljen e dispozitave të Kodit qëndron mbi FSHF-në e cila përfaqësohet nga Oficeri i Integritetit.

Nën-seksioni 3: Afatet kohore

Neni 48. Fillimi dhe mbarimi i afatit kohor

1. Afatet e njoftuara drejtpërsëdrejti për palën ose për një përfaqësues të caktuar nga pala fillojnë një ditë pas marrjes së njoftimit.
2. Kur një dokument i dërgohet një personi nëpërmjet shoqatës anëtare përkatëse dhe nuk i dërgohet personit përkatës ose përfaqësuesit të tij ligjor, afati fillon katër ditë pas marrjes së dokumentit nga shoqata përgjegjëse për përcjelljen e tij. Kur dokumenti i është dërguar edhe personit në fjalë ose përfaqësuesit të tij ligjor, afati kohor fillon në ditën pas marrjes së dokumentit në fjalë.
3. Nëse dita e fundit e afatit kohor përkon me një festë publike në vendin e vendbanimit të personit që kërkohet të pajtohet me dokumentin brenda afatit të caktuar, afati përfundon në ditën e ardhshme të punës.

Neni 49. Pajtueshmëria

1. Afati kohor përmbushet vetëm nëse veprimi i kërkuar është kryer para skadimit të afatit kohor.
2. Dokumenti duhet të dorëzohet me e-mail në adresën e postës elektronike të treguar në korrespondencën e dërguar nga sekretariati përkatës tek organi përkatës jo më vonë se mesnata në ditën e fundit të afatit.

3. Shpenzimet dhe tarifatat e pagueshme konsiderohen se janë paguar në kohë nëse pagesa është bërë në mënyrë të pakthyeshme në llogarinë e FSHF-s deri në mesnatë në ditën e fundit të afatit kohor.

Neni 50. Shtyrja

1. Afatet kohore të përcaktuara në këtë Kod nuk mund të shtyhen.
2. Afatet kohore të përcaktuara nga Komisioni i Etikës mund të shtyhen me kërkesë të arsyetuar. Afati kohor mund të zgjatet për herë të dytë vetëm në rrethana të jashtëzakonshme.
3. Nëse refuzohet shtyrja e afatit, mund të jepen dy ditë shtesë. Në raste urgjente, refuzimi për të dhënë shtyrjen mund të shpallet verbalisht.

***Nën-seksioni 4:* Pezullimi i procedurave**

Neni 51. Pezullimi ose vazhdimi i procedurave

1. Në rast se personi i lidhur me këtë Kod pushon së shërbyeri në funksionin e tij gjatë procedurës, Komisioni i Etikës mbetet kompetent për të vazhduar procedurat hetimore dhe/ose për të marrë një vendim.
2. Në rast se një person i lidhur me këtë Kod pushon së shërbyeri në funksionin e tij, Oficeri i Integritetit mund të iniciojë dhe zhvillojë hetimin, të krijojë një raport përfundimtar dhe t'ia dorëzojë atë Komisionit të Etikës. Komisioni mund të pezullojë procedurat ose të marrë një vendim në lidhje me thelbin dhe të vendosë dënime të përshtatshme.

Nën-seksioni 5: Shpenzimet procedurale**Neni 52. Shpenzimet procedurale**

Shpenzimet procedurale përbëhen nga kostot dhe shpenzimet e Komisionit të Etikës që janë bërë në lidhje me procedurat hetimore dhe gjyqësore.

Neni 53. Shpenzimet procedurale në rast të mbylljes së procedurës ose shfajësimit

1. Përveç kur parashikohet ndryshe, në rast të mbylljes së procedurës ose shfajësimit, shpenzimet procedurale do të përballohen nga FSHF.
2. Një palë mund të urdhërohet që të paguajë shpenzimet procedurale, pjesërisht ose tërësisht, në rast të mbylljes së procedurës ose të shfajësimit, nëse ajo me faj ka shkaktuar fillimin ose pengimin e zhvillimit të procedurës.

Neni 54. Shpenzimet procedurale nëse vendosen dënime

1. Shpenzimet procedurale do të mbulohen nga pala që është dënuar.
2. Nëse është dënuar më shumë se një palë, shpenzimet procedurale do të vlerësohen proporcionalisht në përputhje me shkallën e fajit të palëve.
3. Një pjesë e shpenzimeve procedurale, në veçanti kostot e procedurave hetimore, mund të përballohen nga FSHF, sipas rastit, në lidhje me vendosjen e dënimeve.
4. Shpenzimet procedurale mund të reduktohen ose të hiqen në rrethana të jashtëzakonshme, në veçanti duke marrë parasysh rrethanat financiare të palës.

Neni 55. Shpenzimet e tjera gjyqësore

Asnjë shpenzim gjyqësor nuk do të rimbursohet në procedurat e kryera nga Komisioni i Etikës.

SEKSIONI 2: Procedurat e hetimit

***Nën-seksioni 1:* Procedurat paraprake**

Neni 56. E drejta për të parashtruar ankesa

1. Çdo person mund të bëjë ankesë lidhur me shkeljet e mundshme të këtij Kodi pranë sekretariatit të përgjithshëm. Ankesat duhet të dorëzohen me shkrim, duke përfshirë dëshminë e disponueshme. Sekretariati informon Oficerin e Integritetit hetimore për ankesat dhe vepron sipas udhëzimeve të tij.
2. Çdo person i lidhur me këtë Kod që paraqet një ankesë kundër një personi të cilin ai e di se është i pafajshëm ose në ndonjë mënyrë tjetër ndërmerri hapa të dëmshëm lidhur me fillimin e procedurës sipas këtij Kodi, do të dënohet me një gjobë të përshtatshme prej të paktën 500,000 (Pesëqindmijë) Lekë si dhe ndalimin e pjesëmarrjes në ndonjë aktivitet që lidhet me futbollin për një minimum prej dy vjetësh.

Neni 57. Hetimet paraprake

1. Oficeri i Integritetit kryen vlerësimin fillestar të dokumenteve të paraqitura me ankesën.
2. Oficeri i Integritetit mund të iniciojë hetime paraprake për një shkelje të mundshme të këtij Kodi në bazë të një ankese të parashtruar dhe vepron sipas udhëzimeve të sekretarit të përgjithshëm. Kjo do të përfshijë, në veçanti, grumbullimin e

informacionit me shkrim, duke kërkuar dokumente dhe marrjen e deklaratave të dëshmitarëve.

3. Oficeri i Integritetit mund të iniciojë hetime paraprake në diskrecionin e tij dhe në çdo kohë.

Neni 58. Hapja e procedurave hetimore

1. Nëse hetimi paraprak rezulton se ka një çështje në *prima facie*, Oficeri i Integritetit hap procedurat hetimore duke shqyrtuar në mënyrë të barabartë rrethanat rënduese dhe lehtësuese.
2. Palët njoftohen për hapjen e procedurave hetimore dhe për shkeljen e mundshme të rregullave. Përrjashtimet e kufizuara për këtë rregull mund të bëhen për arsye sigurie ose nëse një zbulim i tillë do të ndërhynte në kryerjen e hetimit.
3. Oficeri i Integritetit duhet t'i raportojë rregullisht sekretarit të përgjithshëm për çështjet e pahapura.

Nën-seksioni 2: Fillimi dhe zhvillimi i procedurave hetimore

Neni 59. Fillimi i hetimit

1. Oficeri i Integritetit vendos për fillimin e procedurës hetimore.
2. Nuk ka nevojë për arsyet për fillimin e procedurës hetimore dhe vendimi nuk mund të ankimohej.

Neni 60. Detyrat dhe kompetencat e Oficerit të Integritetit

1. Oficeri i Integritetit mund të hetojë shkeljet e mundshme të dispozitave të këtij Kodi me nismën e vet ose në bazë të ankesave në diskrecion të plotë dhe të pavarur.

2. Nëse Oficeri i Integritetit gjykon se nuk ka çështje *prima facie*, ai/ajo nuk hap procedurë hetimore dhe mbyll çështjen. Përveç mbylljes së brendshme të procedurës, Oficeri i Integritetit mund (i) t'i dërgojë një letër përmbyllëse palës së interesuar duke e kujtuar atë për detyrat e saj dhe/ose (ii) t'i dërgojë një letër përmbyllëse palës së interesuar duke e informuar atë se nuk janë gjetur shkelje të Kodit.
3. Sapo të përfundojë hetimi, Oficeri i Integritetit do të përgatisë një raport përfundimtar mbi procedurat hetimore duke deklaruar rregullat përkatëse që janë shkelur për të cilat kërkohet një gjykim nga Komisioni i Etikës. Raporti, së bashku me dosjet përkatëse të hetimit, do të përcillen në Komisionin e Etikës.
4. Nëse procedura është mbyllur, Oficeri i Integritetit mund të rihapë hetimin nëse paraqiten fakte ose prova të reja që sugjerojnë se një shkelje e mundshme është konsumuar.
5. Si pjesë e procesit hetimor, Oficeri i Integritetit mund të hetojë gjithashtu shkeljet e dispozitave të Kodit të Disiplinës së FSHF-s që kanë të bëjnë me sjelljen imorale ose joetike.

Neni 61. Kryerja e procedurave

Oficeri i Integritetit mund ta drejtojë vetë procedurën hetimore si shef i hetimit ose mund t'ia caktojë këtë rol formalisht një personi brenda strukturës. Ky person do të caktohet shefi i hetimit.

Neni 62. Kompetencat e shefit të hetimit

1. Me ndihmën e sekretariatit, shefi i hetimit do të hetojë me anë të pyetjeve me shkrim dhe pyetjeve me shkrim ose me gojë drejtuar palëve dhe dëshmitarëve. Ai gjithashtu mund të ndërmarrë masa të mëtejshme hetimore që lidhen me rastin; në veçanti, ai mund të verifikojë vërtetësinë e dokumenteve relevante për hetimin duke siguruar deklaratata.

2. Nëse Oficeri i Integritetit vepron si shef i hetimit, ai në raste komplekse mund të angazhojë palë të treta - me detyra hetimore - nën drejtimin e tij. Kërkesat që duhet të bëhen nga palë të treta duhet të përcaktohen qartë. Kur kryetari nuk vepron si shef i hetimit, shefi i hetimit mund t'i paraqesë kryetarit kërkesën përkatëse.
3. Nëse palët dhe subjektet e tjerë të lidhur me këtë Kod dështojnë të bashkëpunojnë në përcaktimin e fakteve të çështjes, shefi i hetimit ose Oficeri i Integritetit mund të vendosë një paralajmërim dhe në rast përsëritjeje të imponojë masat disiplinore, duke përfshirë ndalimin e pjesëmarrjes në ndonjë aktivitet që lidhet me futbollin deri në 90 ditë.

Nën-seksioni 3: Përfundimi i procedurave hetimore

Neni 63. Përfundimi i procedurave hetimore

Nëse shefi i hetimit e konsideron hetimin të përshtatshëm, ai duhet të informojë palët se procedurat hetimore janë përfunduar dhe do të përcjellë raportin përfundimtar së bashku me dosjet e hetimit në Komisionin e Etikës.

Neni 64. Raporti përfundimtar

1. Raporti përfundimtar duhet të përmbajë të gjitha faktet dhe provat përkatëse të mbledhura dhe të përmendë shkeljet e mundshme të rregullave.
2. Raporti përfundimtar nënshkruhet nga Oficeri i Integritetit. Nëse Oficeri i Integritetit nuk ka vepruar si shefi i hetimit, shefi i hetimit do të nënshkruajë gjithashtu raportin përfundimtar.

Neni 65. Procesi i pranimit të fajësisë (zbatimi i një dënimi me pëlqimin e ndërsjellë)

1. Në çdo kohë gjatë hetimit, por jo më vonë se çështja t'i ketë kaluar Komisionit të Etikës ose para seancës, siç parashikohet nga neni 74 i këtij Kodi, palët mund të lidhin marrëveshje me Oficerin e Integritetit për zbatimin e një dënimi me pëlqimin e ndërsjellë.
2. Nëse kryetari i Komisionit të Etikës merr parasysh se marrëveshja është në përputhje me këtë Kod dhe dënimi i vendosur zbatohet në mënyrë korrekte, marrëveshja hyn në fuqi menjëherë dhe dënimi i vendosur bëhet përfundimtar dhe i detyrueshëm dhe nuk i nënshtrohet asnjë ankimi të mëtejshëm.
3. Nëse një dënim monetar i parashikuar nga marrëveshja e pranimit të fajësisë nuk zbatohet plotësisht nga pala në fjalë brenda 15 ditëve nga data e vendimit, marrëveshja do të revokohet automatikisht.
4. Nëse një trajnim i përputhshmërisë dhe/ose punë sociale që parashikohet nga marrëveshja e pranimit të fajësisë nuk do të ekzekutohet plotësisht nga pala e interesuar brenda afateve të përcaktuara në marrëveshje, marrëveshja revokohet automatikisht.
5. Kurdo që marrëveshja mbi pranimin e fajësisë të revokohet, Komisioni i Etikës do të vendosë për çështjen brenda 60 ditëve që pasojnë në bazë të dosjes dhe nuk do të lejohet ndonjë marrëveshje tjetër për pranimin e fajësisë ndërmjet palëve të interesuara.
6. Asnjë marrëveshje mbi pranimin e fajësisë nuk lejohet në lidhje me dënimet që lidhen me shkeljet e ryshfetit, keqpërdorimin e fondeve dhe manipulimin e ndeshjeve ose garave të futbollit.

SEKSIONI 3: Procedurat Gjyqësore***Nën-seksioni 1:*** Fillimi dhe zhvillimi i procedurave**Neni 66. Detyrat dhe kompetencat e Komisionit të Etikës**

1. Kryetari i Komisionit të Etikës shqyrton raportin përfundimtar dhe dosjet e hetimit me ndihmën e sekretariatit.
2. Nëse kryetari i Komisionit të Etikës gjykon se nuk ka prova të mjaftueshme për të vazhduar, ai mund ta mbyllë çështjen dhe të njoftojë palën në përputhje me rrethanat.
3. Nëse kryetari i Komisionit të Etikës gjykon se çështja duhet të gjykohet, ai duhet të vazhdojë me procedurën gjyqësore dhe të kërkojë që sekretariati t'i dërgojë një kopje të raportit përfundimtar dhe dosjeve të hetimit palëve të interesuara.

Neni 67. Procedurat Gjyqësore

1. Kryetari i Komisionit të Etikës duhet të informojë të gjitha palët e interesuara që çështja duhet të vendoset ose në bazë të raportit të Oficerit të Integritetit së bashku me dosjet hetimore ose - me kërkesë të cilësdo palë të interesuar – me një seancë dëgjimore që duhet të planifikohet.
2. Nëse nuk ka kërkesë për seancë, kryetari i Komisionit të Etikës informon palët për procedurën dhe Inspektorin e Disiplinës që çështja të vendoset në bazë të dokumenteve dhe parashtresave ekzistuese dhe vendos një afat përfundimtar për paraqitjen e kërkesave të tyre përkatëse përfundimtare.
3. Nëse do të mbahet një seancë dëgjimore, sekretariati i Komisionit të Etikës do të informojë të gjitha palët e interesuara.
4. Të gjitha palët në procedurë dhe përfaqësuesit e tyre, sipas nenit 38 par. 4, si dhe përfaqësuesit e Oficerit të Integritetit kanë të drejtë

të marrin pjesë në seancë dëgjimore për të diskutuar dhe paraqitur verbalisht kërkesat e tyre përkatëse.

5. Si pjesë e procesit gjyqësor, Komisioni i Etikës mund të vendosë gjithashtu për shkelje të dispozitave të Kodit Disiplinor të FSHF-s që kanë të bëjnë me sjelljen e pamoralshme ose joetike.

Neni 68. Juridiksioni i kryetarit të Komisionit të Etikës si gjyqtar i vetëm

1. Kryetari i Komisionit të Etikës mund të marrë i vetëm vendime në rastet që lidhen me shkeljet e dënueshme vetëm me dënime monetare ose kur dënimi që duhet të vendoset është një paralajmërim, vërejtje ose pajtim.
2. Kryetari i Komisionit të Etikës është gjithashtu përgjegjës për ratifikimin e marrëveshjes së pranimit të fajësisë të lidhur ndërmjet palëve dhe Oficerit të Integritetit, aty ku është e zbatueshme.

Neni 69. E drejta për t'u dëgjuar

Para se Komisioni i Etikës të dal me vendim përfundimtar, palët kanë të drejtë të paraqesin pozicionin e tyre, të paraqesin dëshmi dhe të inspektojnë prova që duhet të shqyrtohen nga Komisioni i Etikës në marrjen e vendimit.

Këto të drejta mund të kufizohen në rrethana të jashtëzakonshme, të tilla si kur çështjet konfidenciale duhet të mbrohen, dëshmitarët duhet të mbrohen ose nëse kërkohet të përcaktojnë elementet e procedurës.

Neni 70. Refuzimi i propozimeve për pranimin e provave

1. Në përputhje me nenet 46 dhe 47 dhe dispozitat e tjera përkatëse të Kodit, kryetari i Komisionit të Etikës mund të refuzojë propozimet e arsyeshme për pranimin e provave të paraqitura nga palët.

2. Palët do të informohen nëse propozimi i tyre është refuzuar me një përmbledhje të shkurtër të arsyeve të vendimit. Refuzimi nuk mund të kontestohet.

Nën-seksioni 2: Përbërja, seancat dëgjimore

Neni 71. Përbërja e panelit

1. Kryetari i Komisionit të Etikës vendos për përbërjen dhe numrin e anëtarëve në panel dhe u siguron atyre dosjet përkatëse. Palët konsiderohen se kanë dijeni për përbërjen e panelit qysh nga emërimi i tyre nga Asambleja e Përgjithshme e FSHF.
2. Pa paragjykuar nenin 70, vendimet e panelit do të konsiderohen të jenë të ligjshme nëse janë të pranishëm të paktën tre anëtarë.

Neni 72. Seancat, parimet

1. Seancat duhet të kryhen me dyer të mbyllura dhe në praninë në vend të palës kërkuese.
2. Sjellja e pahijshme nga pala që ndodh pas dorëzimit të raportit përfundimtar mund të adresohet nga Oficeri i Integritetit gjatë deklaratës së saj përmblyëse. Në këtë kuptim, Oficeri i Integritetit mund të paraqesë faktet dhe provat relevante, të përmendë shkeljet e mundshme të rregullave dhe të paraqesë një rekomandim në Komisionin e Etikës mbi masat e duhura. Pala duhet të ketë të drejtë t'i përgjigjet këtyre akuzave të reja gjatë seancës dëgjimore.
3. Nëse nuk ka seancë dëgjimore, kryetari do të planifikojë diskutimet dhe do të vendosë për numrin e anëtarëve dhe përbërjen e panelit. Palët do të informohen për këtë qëllim.

Neni 73. Seancat, procedurat

1. Kryetari i Komisionit të Etikës e organizon seancën në çfarëdo mënyre që ai e gjykon të përshtatshme, me kusht që të jetë në përputhje me Kodin.
2. Është përgjegjësi e palëve të sigurojnë paraqitjen e dëshmitarëve të kërkuar nga ata dhe të paguajnë të gjitha kostot dhe shpenzimet që lidhen me paraqitjen e palëve dhe dëshmitarëve.
3. Dëshmitarët e thirrur nga palët dhe/ose nga Oficeri i Integritetit duhet të paraqiten personalisht.
4. Kurdoherë që është e mundur, seanca duhet të procedohet sipas rendit në vijim:
 - (a) dëshmia e çdo dëshmitari të thirrur nga i akuzuari dhe e aprovuar nga Komisioni i Etikës;
 - (b) dëshmia e çdo dëshmitari të thirrur nga Oficeri i Integritetit dhe e aprovuar nga Komisioni i Etikës;
 - (c) dëshmia e çdo dëshmitari të thirrur nga Komisioni i Etikës;
 - (d) deklarata e mbylljes nga Oficeri i Integritetit;
 - (e) deklarata përmbyllëse nga një përfaqësues ligjor, nëse ka, e të akuzuarit;
 - (f) deklarata e kundërshtimit nga Oficeri i Integritetit dhe palët, nëse është e zbatueshme;
 - (g) mundësi përfundimtare për të akuzuarin për të folur.

Nën-seksioni 3: Shqyrtimet, vendimet

Neni 74. Shqyrtimet

1. Pas seancës dëgjimore, trupa gjykuese do të tërhiqet për të shqyrtuar vendimin e saj privatisht.

2. Nëse rrethanat e lejojnë, shqyrtimi dhe marrja e vendimeve mund të kryhen përmes konferencës telefonike, videokonferencës ose ndonjë metode tjetër të ngjashme.
3. Shqyrtimet kryhen pa ndërprerje, përveç nëse ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme.
4. Kryetari do të vendosë për mënyrën sesi pyetjet e ndryshme do të dorëzohen për shqyrtim.
5. Komisioni i Etikës nuk është e detyruar me vlerësimin ligjor të fakteve të paraqitura nga Oficeri i Integritetit. Në veçanti, Komisioni i Etikës mund të zgjasë ose të kufizojë shkeljet e rregullave të theksuara nga Oficeri i Integritetit.
6. Anëtarët e pranishëm duhet të shprehin mendimet e tyre sipas rendit të caktuar nga kryetari, i cili gjithmonë flet i fundit.
7. Një anëtar i sekretariatit do të jetë i pranishëm gjatë shqyrtimit për mbajtjen e procesverbalit.

Neni 75. Marrja e vendimit

1. Vendimet merren nga shumica e anëtarëve të pranishëm.
2. Çdo anëtar i pranishëm voton.
3. Në rast të një barazimi votash, kryetari do të ketë votën vendimtare.

Neni 76. Vendimi i Arsytuar

1. Komisioni i Etikës duhet të komunikojë vendimin e saj në formë të plotë me shkrim.
2. Në rast urgjence, ose në rrethana të tjera të veçanta, Komisioni i Etikës mund t'i njoftojë palës vetëm dispozitivin e vendimit, i cili bëhet menjëherë i zbatueshëm. Vendimi i plotë, me shkrim, do të njoftohet brenda 30 ditëve të ardhshme.

Neni 77. Forma dhe përmbajtja e vendimit

1. Vendimi përmban:
 - (a) përbërjen e panelit;
 - (b) emrat e palëve;
 - (c) datën e vendimit;
 - (d) një përmbledhje të fakteve;
 - (e) arsyet e vendimit;
 - (f) dispozitat mbi të cilat është bazuar vendimi;
 - (g) kushtet e vendimit;
 - (h) njoftimin e mundësive për ankimim.
2. Vendimi nënshkruhet nga të gjithë anëtarët prezent dhe njoftohet nga sekretariati.

Neni 78. Ekzekutimi i vendimeve

Është përgjegjësi e FSHF-së, klubeve dhe shoqatave anëtare, si dhe e zyrtarëve përkatës të futbollit, për të siguruar që vendimet e marra dhe të njoftuara nga Komisioni i Etikës të zbatohen siç duhet, siç kërkohet nga Statutet e FSHF-së.

Seksioni 4: Ankimi dhe rishikimi

Neni 79. Ankimimi

Pala ankuese mund t'i paraqesë ankim kundër vendimit të Komisionit të Etikës në Gjykatën e Arbitrazhit Sportiv (CAS/TAS) Lozanë, Zvicër.

Neni 80. Gjykata e Arbitrazhit Sportiv (CAS/TAS)

1. Vendimet e marra nga Komisioni i Etikës janë të formës së prerë, dhe mund të apelojnë në Gjykatën e Arbitrazhit Sportiv (CAS/TAS) në përputhje me dispozitat përkatëse.
2. Vendimet e lartpërmendura gjithashtu mund të apelojnë në CAS nga Oficeri i Integritetit.

Neni 81. Rishikimi

1. Oficeri i Integritetit mund të rihapë një çështje që është mbyllur pas një vendimi ligjor detyrues, nëse një palë zbulon fakte të reja të rëndësishme ose dëshmi që, pavarësisht hetimit, nuk mund të ishin paraqitur më herët dhe do të kishte rezultuar me një vendim më të favorshëm. Në rast të rishikimit së tillë, do të zbatohen dispozitat lidhur me procedurat hetimore.
2. Një kërkesë për rishikim mund të bëhet nga pala në fjalë brenda 10 ditëve nga zbulimi i arsyeve për rishikim, ose ndryshe nuk do të pranohet.
3. Periudha e parashkrimit për paraqitjen e kërkesës për shqyrtim është një vit pas zbatimit të vendimit.

Seksioni 5: Dënimet e përkohshme

Neni 82. Kushtet, juridiksioni, procedura

1. Në çdo kohë gjatë një hetimi, Oficeri i Integritetit ose shefi i hetimit mund të zbatojë dënime të përkohshme me qëllim që të sigurohet se nuk do të ketë ndërhyrje në procedurat e hetimit ose kur duket se është kryer një shkelje e këtij Kodi dhe vendimi përfundimtar nuk mund të merret në kohë të mjaftueshme.

2. Pala e interesuar mund të paraqesë ankesë kundër dënimeve të përkohshme pranë kryetarit të Komisionit të Etikës brenda pesë ditëve nga njoftimi i dënimeve të përkohshme.
3. Kryetari i Komisionit të Etikës vendos pa vonesë mbi ankimin në bazë të dosjes ose mund të vendosë të dëgjojë palët e interesuara ose përfaqësuesit e tyre.

Neni 83. Kohëzgjatja

1. Dënimet e përkohshme mund të jenë të vlefshme për një maksimum prej 90 ditësh. Në rrethana të jashtëzakonshme, dënimet e përkohshme mund të shtyhen nga kryetari i Komisionit të Etikës me kërkesë të Oficerit të Integritetit për një periudhë shtesë që nuk kalon 90 ditë.
2. Kohëzgjatja e dënimeve të përkohshme do të merret parasysh në vendimin përfundimtar.

Neni 84. Përjashtimi nga përgjegjësia

Përveç rastit të neglizhencës së rëndë ose të qëllimshme, as anëtarët e Komisionit të Etikës dhe as stafi i sekretariatit nuk mund të jenë personalisht përgjegjës për çdo veprë që lidhet me ndonjë procedurë.

PJESA IV: DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 85. Miratimi dhe zbatimi

1. Asambleja e Përgjithshme e FSHF-së e miratoi këtë Kod më 15.04.2019.
2. Ky Kod hyn në fuqi më 01.08.2019.

Për Asamblenë e Përgjithshme

Presidenti

Sekretari i Përgjithshëm

